



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

AD.nr.4/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, U.D. Kryetari i Gjykatës Artan Sejrani, në çështjen e hetimit disiplinor, duke vepruar sipas ankesës për iniciimin e procedurës disiplinore të datës 31.03.2022 e parashtruar nga M.S., nga Republika e Maqedonisë së Veriut, ndaj gjyqtarit A.H., me datë 20.04.2022 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar kërkesa e M.S., nga Republika e Maqedonisë së Veriut e parashtruar me datën 31.03.2022, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit A.H.,

A r s y e t i m

Parashtruesi i kërkesës me datën 31.03.2022 ka parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit A.H., nga përmbajtja e kërkesës parashtruesi ka shprehur pakënaqësi në lidhje me procedurën e përmbartimit E.nr., duke pretenduar se ka pasur zvarritje të procedurës përkundër faktit që këto procedura janë të natyrës urgjente prandaj gjyqtari i çështjes A.H., i ka shkelur dispozitat ligjore të nenit 31 të Kushtetutës, nenit 3 dhe 13 të KEDNJ.

Gjyqtari A.H., me parashtrues të veçantë ka përshkruar ka theksuar se duke proceduar me tej në këtë çështje juridike kontestimore, unë si gjykatës, për të vepruar sa më shpejt që është e mundur në procedimin e lëndëve të pambarimit, përfshirë edhe këtë lëndë, unë si gjykatës, pasi që jam caktuar si gjykatës i lëmisë së përmbartimit me datë 01.01.2013, kam ndërmarr veprimin procedural në atë mënyrë që pasi që gjykatësi i mëhershëm, në procesverbalin e dt.06.03.2012, ka theksuar se do të procedon për çështjen pasi nuk disponon me listat poseduese të cilat udhëhiqen në emër të debitorit, unë si gjykatës, ia jam drejtuar Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Prizren, me shkresën, E.nr. të dt.06.03.2013 për sigurimin e tyre si dhe kam ndërmarr veprime përmbartimore e të cilat i keni të bashkangjitur, kësaj përgjigje në ankesën e palës kreditore në fjalë dhe se veprimi i fundit procedural i planifikuar që të ndërmerret nga unë si ish gjykatës i lëmisë së përmbartimit, e në lëndën e përmbartimit, E.nr....., ka qenë, dalja në vend me dt.09.07.2018 e me fillim në ora 13:10 minuta e për regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin e më pas shitjen e sendeve të debitorit e me qëllim të realizimit të kredisë në të holla të kreditorit mirëpo për shkak të grevës së gjykatësve të kësaj Gjykate, gjatë muajit korrik 2018, nuk është mbajtur seanca e daljes në vend.

U.d. Kryetari i Gjykatës pas hetimit paraprak, shikimit në shkresat e lëndës penale E.nr....., analizimit të kërkesës së parashtrueses, deklaratës së gjyqtarit të çështjes, konstaton se kërkesa **është e pa bazuar**.

U.d. Kryetari i gjykatës fillimisht konstaton se parashtruesi i kërkesës në këtë lëndë është në cilësi të kreditorit sipas propozimit për përmbartim të aktgjykimit të Gjykatës Komunale në

Prizren C.nr., të datës 16.05.2008 i lejuar sipas aktvendimit të kësaj Gjykate E.nr. 1217/10, të datës të datës 08.02.2010 për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 19.382 Euro kundër debitorit M.K., nga Prizreni. Gjyqtari i çështjes siç shihet nga shkresat e lëndës, lëndën e ka pranuar 01.01.2013 dhe ka ndërmarrë disa veprime procedurale dhe vendime në këtë procedurë të përmbartimit.

U.d. Kryetari i gjykatës lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit gjeti se të njëjtat nuk qëndrojnë, në ankesën e tij parashtruesi ka theksuar se në lëndën përmbartimore ka pasur zvarritje të procedurës nga ana e gjyqtarit. Në ankesën e tij nuk ka përmendur ndonjë rrethanë apo shkelje të caktuar të gjyqtarit së rastit ashtu siç kërkohet edhe me dispozitat ligjore në fuqi të ligjit nr. 06/1 - 057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në ankesën e tij nuk ka bërë një përshkrim konciz të aspekteve faktike dhe juridike mbi të cilat është ngritur dyshimi për shkelje disiplinore kundër gjyqtarit në fjalë por ka shprehur pakënaqësi lidhur me zvarritjen e procedurës. Mirëpo sipas shkresave të lëndës del se gjyqtari i çështjes ka qenë i ngarkuar me këtë lëndë prej vitit 2013 deri në vitin 2020 ku edhe e ka dorëzuar këtë lëndë një gjyqtari tjetër dhe nga shkresat e lëndës rezulton se gjyqtari ka ndërmarrë veprime procedurale dhe atë me datën 21.03.2013 ka mbajtur seancë dëgjimore dhe të njëjtën datë i është drejtuar Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër për sigurimin e të dhënave, po ashtu me datën 16.07.2013, dhe 08.10.2013 janë mbajtur seanca. Me datën 09.10.2013 është nxjerrë konkluzioni me të cilin është urdhëruar debitorit që ti deklarojë pasuritë e tij për përmbartim, me datën 10.02.2014 është nxjerrë konkluzioni me të cilin është udhëzuar personi tretë H.K., në procedurë kontestimore, me datën 16.05.2014 është nxjerrë aktvendim me të cilin është hedh poshtë ankesa e debitorit M.K., me datën 27.06.2014 është mbajtur seancë po ashtu janë marrë edhe aktvendim për bllokimin e llogarive bankare të debitorit drejtuar bankave të cilat operojnë në Kosovë, dhe siç shihet edhe nga shkresat e lëndës gjyqtari i çështjes në vazhdimësi ka ndërmarrë veprime procedurale dhe vendim në këtë çështje deri më datën 27.03.2019. Andaj nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës për inicim të procedurës disiplinore sepse gjyqtari i çështjes vazhdimisht ka ndërmarrë veprime procedurale dhe vendime përmbartimore në kuadër të kompetencave të tij gjyqësore.

Andaj siç u theksua më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 9 par.6 lidhur me nenin 17 par.5 të ligjit nr. 06/1 - 057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
AD.nr. 4/2022, datë 20.04.2022

022

U.D. Kryetari i Gjykatës
Artan Sejrani



Këshillë Juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk parashihet e drejta e ankesës.